

VENDIM
Nr.243, datë 20.4.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, 19, pika 4, 21, pika 3, 23, pika 1, 29, pikat 1, 2 e 6, 33, pika 6, 37, pikat 1 e 4, 56, pika 7, 81, pika 4, 84, pika 4, 91, pika 3, dhe 140, pika 1, të ligjit nr.79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në seksionin A, të kreut III, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Pas pranimit të kërkesës, autoriteti i kufirit dhe migracionit pajis brenda 5 (pesë) ditëve të huajin me leje provizore.”.

2. Pikat 2 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. I huaji pajiset me dokumentin biometrik, leje qëndrimi për të huaj, sipas përcaktimeve të ligjit nr.79/2021, “Për të huajt”, dhe paraqitet personalisht për aplikimin dhe tërheqjen e dokumentit biometrik. Përfundimisht, lejet e qëndrimit të tipit “A”, leja provizore, leja e qëndrimit dhe leja unike që me marrëveshje ndërqeveritare është përcaktuar ndryshe, nuk janë biometrike.”.

“4. Format i lejes provizore të qëndrimit, si dhe formati i lejes për motive humanitare të tipit “A”, sipas parashikimeve të nenit 37, të ligjit nr.79/2021, “Për të huajt”, lëshohen vetëm në formë elektronike, duke iu përmbajtur kushteve të sigurisë. Format i këtyre lejeve është përcaktuar në aneksin nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një format standard i lejes provizore të qëndrimit dhe i lejes për motive humanitare, zbatohet ky format.”.

3. Në fund të pikës 5 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një formular standard i aplikimit për leje unike qëndrimi, zbatohet ky formular.”.

4. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një formular standard i aplikimit për leje qëndrimi për këto kategori, zbatohet ky formular.”.

5. Në pikën 7, pas fjalëve “... shtetasit e Republikës së Kosovës ...” shtohet fjala “... si ...”.

6. Në pikën 9, pas togfjalëshit “... në gjuhën shqipe ...” shtohen fjalët “... i lëshuar në 6-mujorin e fundit ...”.

7. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Për kategoritë e lejeve, të cilat kërkojnë dëshmi të burimeve të mjaftueshme financiare për jetesën në Republikën e Shqipërisë, ajo konsiston në:

a) paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare në bankat e nivelit të dytë, personale apo familjare, në Shqipëri, jo më pak se 300 000 lekë për person (për 1 (një) vit kalendarik);

b) vërtetimi i të ardhurave mujore jo më pak se 32 000 lekë për person.”.

8. Në pikën 11 bëhen këto ndryshime:
- a) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“b) afati i lejes së qëndrimit të jetë i njëjtë me afatin e aplikimit për herë të parë.”
 - b) Fjalja e dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Nëse i huaji kërkon të ndryshojë motivin e lejes së qëndrimit, brenda afatit të vlefshmërisë së lejes (me përjashtim të lejes për herë të parë), ai mund të aplikojë për një leje të re qëndrimi pas dorëzimit të lejes së vlefshme të qëndrimit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin dhe plotësimin të kushteve të përmendura në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike.”.
9. Pas pikës 11 shtohet pika 12, me këtë përmbajtje:
“12. I huaji i pajisur me leje qëndrimi ka detyrimin të bëjë regjistrimin e adresës, duke u paraqitur personalisht pranë zyrës përgjegjëse të gjendjes civile ose *on-line*”.
- II. Në seksionin B, të kreut III, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Në fjalinë e parë të këtij seksioni hiqet lidhëza “edhe”.
 2. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:
“3. Dokumentet që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri.
 4. Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar reciprocitet në thjeshtimin e dokumentacionit për përfitimin e lejes së qëndrimit, zbatohen përcaktimet në marrëveshje.”.
- III. Në shkronjën “ç”, të pikës 2, të seksionit C, të kreut III, pas nënndarjes “iii” shtohen nënndarjet “iv”, “v” dhe “vi”, me këtë përmbajtje:
- “iv. Dëshmi penale e legalizuar nga vendi i origjinës;
 - v. Vërtetim mjekësor se nuk ka qenë në trajtime psikoterapie dhe psikologjike në vendin e origjinës;
 - vi. Para marrjes së dokumentit biometrik, i huaji, që ka aplikuar për këtë leje unike, dorëzon pranë autoriteti rajonal për kufirin dhe migracionin, ku ka kryer aplikimin, një policë të sigurimit shëndetësor nga sëmundjet dhe aksidentet, të vlefshme për periudhën e qëndrimit në Shqipëri.”
- IV. Në seksionin “Ç”, të kreut III, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Në pikën 1, pas fjalës “... *on-line* ...” shtohen fjalët “... pas kryerjes së pagesës, e cila është e pakthyeshme ...”.
 2. Në pikën 9, fjalja “Shqyrtimi i kërkesës nga secili institucion përgjegjës duhet bërë brenda një afati maksimal prej 2 javësh” shfuqizohet.
- V. Në shkronjën “gj”, të seksionit “D”, të kreut III, pas nënndarjes “iii” shtohet nënndarja “iv”, me këtë përmbajtje:
“iv. Policë të sigurimit shëndetësor, të vlefshme për të paktën 1 (një) vit.”.
- VI. Në seksionin “E”, të kreut III, pas paragrafit ekzistues shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Për personat, që kanë përfituar statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin, duhet të dorëzojnë vendimin e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, për dhënien e këtij statusi.”.
- VII. Pika 3, e seksionit “Ë”, të kreut III, shfuqizohet.
- VIII. Në kreun IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Në pikën 2, fjalët “... brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e tij ...” zëvendësohen me “...brenda datës 1 shtator 2022 ...”.
 2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:
“2/1. Parashikimet e shënuara me (*) në formularin e aplikimit për leje unike do të hyjnë në fuqi pas datës 1 shtator 2022.
 - 2/2. Aplikimi për regjistrimin e adresës do të mundësohet edhe *on-line* pas datës 1 shtator 2022.”.
- IX. Pika 3, e aneksit nr.3, bashkëlidhur vendimit, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë për motive turistike në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentin pasaportë për një periudhë të kufizuar/për periudhën nga **data 20 prill deri më 31 dhjetor**:

Nr.	Shteti
1	Arabi Saudite
2	Bahrein
3	Egjipt*
4	Indi
5	Katar
6	Oman
7	Rusi*
8	Tailandë

** Shtetasit e shteteve të shënuara me simbolin (*), hyjnë pa vizë për motive turistike në Republikën e Shqipërisë dhe me dokumentin pasaportë, për një periudhë të kufizuar/për periudhën nga data **1 maj deri më 30 shtator**.*

X. Në aneksin nr.5, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa:

1. Fushat në pikën 37 deri në pikën 42 të formularit plotësohen nga të huajt të cilët kërkojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim bashkimin familjar.

2. Pas pikës 49 shtohet shënimi:

“Ky formular nuk do të aplikohet pas datës 1 shtator 2022 për të huajt që aplikojnë për leje unike.”.

XI. Anekset nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, që i bashkëlidhen vendimit në fuqi, zëvendësohen me anekset me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneksi nr. 6

Vlera e tarifave të shërbimit dhe pajisjes me leje qëndrimi dhe leje unike për të huajt ¹ .						
Nr.		Tarifa e lejes më shumë se 90 ditë deri në 1 vit, për herë të parë ² .	Tarifa e lejes deri në 2 vjet, për herë të parë.	Tarifa e lejes deri në 3 vjet, për herë të parë.	Tarifa për ripërtëritjen e lejes.	Tarifa e lejes së përhershme të qëndrimit.
1.	Për motive të bashkimit familjar	4 500 (mijë lek)	-	-	2 250	12 500
2.	Për motive studimi (student dhe nxënës)	4 500	-	-	2 250	-
3.	Për të trajnuarin pa pagesë	4 500	-	-	2 250	-
4.	Për au pairs	4 500	-	-	2 250	-
5.	Për shkëmbime rinore	4 500	-	-	2 250	-
6.	Për kërkim shkencor	4 500	-	-	-	-
7.	Për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët	4 500	-	-	-	-
8.	Për raste humanitare	Pa tarifë	-	-	Pa tarifë	-
9.	Për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore	Pa tarifë	-	-	Pa tarifë	-
10.	Për personat pa shtetësi	4 500	-	-	2 250	12 500
11.	Leje unike si punëmarrës	8 000	9 000	10 000	4 000	12 500
12.	Leje unike për punësim stinor	4 500	-	-	-	-
13.	Leje unike për të transferuar brenda ndërmarrjes	8 000	-	-	4 000	-
14.	Leje unike si punëtor ndërkufitar	4 500	-	-	2 250	-
15.	Leje unike për formim profesional	8 000	9 000	-	4 000	-
16.	Leje unike për sportistë	8 000	-	-	4 000	12 500
17.	Leje unike për shërbim vullnetar	4 500	-	-	2 250	-

¹ Këto tarifa nuk përfshijnë kostot e vlerës së kartës biometrike.

18.	Leje unike për punonjës me kualifikim të lartë	-	9 000	-	4 500	12 500
19.	Leje unike për persona të vetëpunësuar	8 000	9 000	10 000	4 000	12 500
20.	Leje unike për punonjës lëvizës digjital	4 500	-	-	2 250	12 500
21.	Leje unike për investitorë	-	9 000	-	4 500	12 500
22.	Leje unike për shërbime kontraktuese	8 000	-	-	4 000	-
23.	Leje unike për kategori të veçanta	8 000	-	-	4 000	12 500
24.	Për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit	8 000	-	-	4 000	12 500
25.	Për leje qëndrimi për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi	8 000	-	-	4 000	12 500
26.	Për leje qëndrimi për pensionistë	4 500	-	-	2 250	12 500
27.	Vlera e tarifës për kategoritë që pajisen me leje qëndrimi 5-vjeçare, për herë të parë, është 12 000 mijë lek.					

Aneksi nr. 7

Formati i lejes provizore të qëndrimit dhe lejes për motive humanitare të qëndrimit të tipit "A"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

LEJE QËNDRIMI PËR TË HUAJT
RESIDENCE PERMIT OF THE FOREIGNER

TIPI _____

Type

Foto
Photograph

EMRI (AT), MBIEMRI _____

Firs name (s), Family name

VENDLINDJA _____

Place of birth

DATËLINDJA dd.mm.yy

Date of birth

NUMRI IDENTITETIT PËR TË HUAJ (FID) _____

Foreigner Identity Number FID

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI _____

Passport Number/ Identification document

SHTETËSIA _____ GJINIA _____

<i>Nationality</i>	<i>Sex</i>
MOTIVI I QËNDRIMIT _____	
<i>Purpose of Stay</i>	
ADRESA NË SHQIPËRI _____	
<i>Address in Albania</i>	
Kjo leje qëndrimi është e vlefshme nga data <u>dd.mm.vv</u> deri më <u>dd.mm.vv</u>	
<i>This Residence Permit is valid from until</i>	
DREJTOR	
<i>Director</i>	

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit	

ANEKSI NR.8

Formulari standard i aplikimit të leje unike



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME

LEJE UNIKE
UNIC PERMIT

APLIKIM PER LEJE UNIKE / UNIC PERMIT APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për leje unike në Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes formularin e aplikimit. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në www.asp.gov.al → English → Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin E të këtij formulari.

This form is for applying for a Albanian unic permit. Carefully fill in the application form. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Read the instructions for filling in the form at www.asp.gov.al → English → Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section E of this form.

Aplikim për
Application for

☐

LEJE UNIKE për herë të parë
A first unic permit

☐

Rinovim LEJE UNIKE
Renewed unic permit

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:
and hereby submit the following information for the processing of my application:

SEKSIONI A / SECTION A

1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant			
1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit Information on Passport or travel document			
☐	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
☐	Numri i Pasaportës Shërbimi / Official passport no.		
☐	Numri i Dokumentit të udhëtimit të refugjatit / Refugee's travel document no.		
☐	Numri i Pasaportës për të huajt / Alien's passport no.		
☐	Dokument tjetër, specifiklo llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
Vendi i lëshimit Country of issue	Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue	Data e skadimit Date of expiry
1.2 Të dhëna personale / Personal data			
Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënës/ Mother's name		Emri i babait/ Father's name	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia / Gender:	☐ Mashkull / Male	☐ Femër / Female	☐ E panjohur / Unknown

Shtetësia (të) / Current citizenship(s)	ID Ballkani i Hapur / Open Balkan		
Keni nevojë për të aplikuar për vizë?*: ☐ PO ☐ JO https://puneteshatme.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/2-REGJIMI-I-VIZAVE-PER-TE-HUAJT-26.11.2021.pdf			
Nëse Po, plotësoni edhe të dhënat më poshtë: tipi i vizës viza numri i hyrjeve të kërkuara viza të tjera data e nisjes data e mbërritjes kufiri i hyrjes së parë mjeti i transportit			
*Kjo fushë bëhet e aplikueshme pas datës 1 shtator 2022.			
Gjendja Civile / Civil status ☐ Martuar / Married ☐ Beqar / Single ☐ Divorcuar / Divorced ☐ I(e) Ve / Widow(er) ☐ Partner Civil / Civil Partner			
☐ Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari / No children in my care ☐ Nr. i fëmijë të mitur në kujdestari			
Ju lutemi deklaroni numrin e fëmijëve në kujdestari pavarësisht nëse ju po aplikoni për leje qëndrimi Shqiptare për ta ose jo. Nëse do të aplikoni për leje qëndrimi për një apo disa fëmijë, duhet të plotësohet një formular aplikimi i veçantë për të/ta. Please state the number of children in custody regardless of whether you are applying for an Albanian residence permit for them or not. If you are going to apply for a residence permit for one or more children, a special application form must be completed.			
Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:	Gjuha mëmë: Mother Tongue:		
1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj. If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.			
Bashkia Municipality		Njësia Administrative Administrative Units	
Fshati/Qyteti City / Town		Rruga Street	
Ndertesa nr. Building No.		Hyrja The Entrance	
Kodi Postar Postal Code		Apartamenti Apartment	
Tel. / Cel. / Fax			
E-mail:			
1.4 Banesa / Residence			
Ambienti i banimit: ☐ Ambient kolektiv pensione /hostel ☐ Hotel Place of residence: Collective accommodation/hotel			
☐ Apartament me: Apartment with			
Kontratë Qira mujore Monthly Rent Contract		m ²	
Qira ditore rezervuar nëpërmjet platformave online Daily rental booked through online platforms		m ²	
Në pronësi Owned		m ²	
Deklaratë Bashkëjetese në ambientet e një të afërmi Declaration of Cohabitation in the premises of a relative		m ²	

Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/ çdo dokument tjetër që provon akomodimin
I am enclosing with the application the rent contract / proof of property/ any other document proving accommodation

SEKSIONI B / SECTION B

2. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania 2.1 Arsyet e qëndrimit/ Grounds for residence

Kur dhe në cilin PKK keni hyrë/do të hyni në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / When and in which BCP did you enter/will you enter to Albania?

Datë/Date: _____ PKK/ BCP: _____ Numri i hyrjeve të mëparshme/ previous entry : _____
Targa e automjetit³: _____ Tipi automjetit: _____ Dokumenti i pronësisë _____

Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri? ⁴/ What are the grounds for your residence in Albania?

- ☐ Punëmarrës / Employed
- ☐ Punë-Institucion Shtetëror / State Institution Employed
- ☐ Punë-Institucion Fetar / _____
- ☐ Punë-Institucion Humanitar / _____
- ☐ I vetëpunësuar / Self-employed
- ☐ Punonjës me kualifikim të lartë (KARTA-BLU –AL) / Highly Qualified employee (KARTA-BLU –AL)
- ☐ Investitor / Investor
- ☐ Shërbime kontraktuese / Contracting services
- ☐ Shërbime Vullnetare/ Voluntary services
- ☐ I transferuar brenda ndërmarrjes / Intra-corporate transferee
- ☐ Formim Profesional/ Vocational training
- ☐ Punëtor Stinor / Seasonal employment
- ☐ Sportist/ Sport
- ☐ Punëtor Ndërkufitar/ _____
- ☐ Punonjës lëvizës digjital/ _____
- ☐ Të specifikohet për të tjera/ Specify for others

2.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay

³ Për tu plotësuar, nëse gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë keni në përdorim një automjet të regjistruar në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë./ To be completed, if during your stay in the Republic of Albania you have in use a vehicle registered in a country outside the Republic of Albania

⁴ Për çdo kategori të jepet informacion mbi specifikat e lejes së qëndrimit/For each category information provided on the specifics of the residence permit

Unë aplikoj për Leje Unike me afat / I'am applying for a permit term:		Shëno Afatin:	
2.3 Informacion mbi punësimin / Information on employment			
Të dhëna mbi vendin e punës / Data on working place:			
☐ Punëdhënës/ Employer		☐ Ndërmarrje / Enterprise	
☐ Institucion / Institution			
Emertimi i biznesit / Institucionit, kodi fiskal: Name of business/institution business, identity code:			
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati, shteti): Address (street address, no, city/town, country):			
Tel. :		E-mail:	
Dokumente pune: / Employment documents:			
☐ Miratim punësimi ☐ Deklarim për punësim* ☐ Vetëdeklarim për qëllime punësimi për rastet Open Ballkan			
Bazuar në shtetësinë/kategorinë e përzgjedhur nga i huaji, në këtë seksion do të shfaqet vetëm alternativa e kërkuar nga ligji (Nëse nuk nevojitet miratim punësimi të shfaqet vetëm vërtetimi i deklartimit). * Bazuar në nenin 80, të ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", ju nuk keni detyrimin për tu pajisur me dokumentin "Miratim punësimi", mjafton të klikoni mbi opsionin e shfaqur "Deklarim për punësim" për të deklaruar punësimin tuaj pranë zyrës së punësimit.			
2.4 Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor / Incomes and health insurance			
☐ Unë kam pagese punësimi I am in paid employment		☐ Unë kam ndërmarrje private I have my private enterprise	
		☐ Shpenzimet e mia i mbulon institucioni The Institution covers my living cost	
Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme së bashku me aplikimin: I am enclosing the following clarifications with my application:			
☐ Fotokopje e Kontratës së punësimi / Copy of Employment Contract			
☐ Vërtetim tatimor për vitin e fundit kalendarik (sigurohet nga nëpunësit e administratës) / Tax statement for the last calendared year (provided by administration officials)			
☐ Vërtetim regjistrimi në Degën e tatim taksave (sigurohet nga nëpunësit e administratës) / Registration certificate in Tax branch (provided by administration officials)			
☐ Dëshmi nga institucioni për mbulimin e shpenzimeve për jetesë / Certificate from the Institution for covering of the living cost			
☐ Dëshmi të arsimimit apo eksperiencës profesionale / Proof of educational or professional experience			
☐ Dëshmi të sigurimit shëndetësor për vitin e fundit kalendarik ⁵ / Health insurance certificate for the last calendared year			
☐ Dëshmi të sigurimit shoqëror për vitin e fundit kalendarik / Social insurance certificate for the last calendared year			

SEKSIONI C / SECTION C

3. Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application
A keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar? Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?
☐ Jo/ No ☐ Po, specifikoj veprën penale dhe sa jeni dënuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment

⁵ Nuk aplikohet për të huajt të kategorisë "au pair", të cilët duhet të dorëzojnë policën e sigurimit të shëndetit nga sëmundjet dhe aksidentet për periudhën e qëndrimit në Shqipëri, para marrjes së lejes biometrike.

A vuani nga ndonjë sëmundje?
Do you suffer from any diseases?

☐ Jo/ No

☐ Po, specifiko sëmundjen: / Yes, specify the disease:

SEKSIONI D / SECTION D

4 DEKLARIME PËRFUNDIMTARE / LAST DECLARATIONS

Foto

Photo

Unë po aplikoj për tu pajisur me Leje Unike në Shqipëri.
Konfirmoj se, informacioni dhe dokumentet e paraqitura në këtë aplikim janë korrekte dhe të sakta.
Unë jam i vetëdijshëm se dorëzimi tek autoritetet përgjegjëse i dokumentacionit dhe informacionit personal të rremë, përbën vepër të dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe ky fakt mund të çojë në refuzimin e Lejes Unike, Lejes së qëndrimit ose të heqjes së tyre, riatdhesimin dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.

I am applying for a Albanian residence permit and hereby affirm that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.

DEKLARUESI:
THE DECLARANT:

☐ Aplikanti
Himself

☐ Personi i autorizuar
The person authorized

☐ _____
Emër/Name, Mbiemër/Surname

☐ Punëdhënësi
Employer

Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia / Gender:	☐ Mashkull / Male	☐ Femër / Female	☐ E panjohur / Unknown
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)			

Vendi dhe data
Place and date _____

Nënshkrimi
Signature _____

Emri me shkronja kapitale
Name in block letters _____

SEKSIONI E / SECTION E

5. Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices

Me poshtë janë listuar sqarimet e nevojshme si shtojcat në këtë aplikim për leje qëndrimi. Gjatë aplikimit duhet të ngarkohen certifikata origjinale dhe deklarata, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, duhet të përkthehen nga përkthyes të autorizuar dhe të legalizohen sipas marrëveshjeve ndërmjet shteteve.

The clarifications listed below are required as appendices to this residence permit application. The original certificates and clarifications must be uploaded when submitting the application; if they are not in Albanian, they must be translated by an authorized translator and must be legalized.

Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.
Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

☐ Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit (originali të paraqitet, kur dorëzon kërkesën për leje qëndrimi)
Photocopy of valid travel document (the original must be presented when submitting the residence permit application)

☐	Dy fotografi (47mmX36mm) të bëra jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit Passport photo (47mmX36mm),
☐	Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 1.4) Clarification of accommodation (documentation referred to in point 1.4)
☐	Dëshmi penaliteti (për ato kategori që kërkohen) Criminal record (for those categories required)
☐	Sqarim i të ardhurave dhe sigurimit shëndetësor (dokumentacione apo sqarime të përmendura në pikën 2.4) Clarification of income source and health insurance (documentation or clarification referred to in point 2.4)
☐	Mandati i pagesës për tarifën e shërbimit (leje unike) Mandate of payment for the service fee (unique permit)
☐	Mandati i pagesës për tarifën e shërbimit (për vizë)* Mandate of payment for the service fee (payment for visa)*
☐	Deklaratë/autorizimi Declaration/ authorization
☐	Dokumente të tjera Other documents

Para dorëzimit të aplikimit, duhet të ngarkoni mandatin e pagesës (pagesë për vizë/leje unike)
Before submitting the application, you must upload the mandate of payment (payment for visa / unique permit)

*Mandati për pagesën e vizës, do të aplikohet në këtë shtojcë pas datës 1 shtator 2022.

SEKSIONI F / SECTION F

6. Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin

To be filled out by the official person to whom the application was submitted

Tipi i lejes që përfitohet:

☐ UNB

afati: _____muaj

_____, më: _____

Nënshkrimi i zyrtarit: _____

Aneksi nr. 9, "Formularët standard të aplikimit për lëshimin e lejeve të qëndrimit të kategorive: për motive të bashkimit familjar, për motive arsimi, trajnimi, kërkimi shkencor, për raste humanitare, për qëndrim të përhershëm dhe për kategori të veçanta"

ANEKSI NR.9

Bashkimi familjar:



REPUBLIKA E SHQIPERISË

KARTA B
Bashkim familjar
Family reunification

ID _____

APLIKIM PER LEJE QENDRIMI / RESIDENCE PERMIT APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për leje qëndrimi Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes formularin e aplikimit. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në www.asp.gov.al → English → Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin E të këtij formulari.

This form is for applying for a Albanian residence permit. Carefully fill in and sign the application. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Read the instructions for filling in the form at www.asp.gov.al → English → Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section E of this form.

Aplikim për:

Application for:

☐

Leje qëndrimi për herë të parë

A first residence permit

☐

Rinovim leje qëndrimi

Renewed residence permit

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:

and hereby submit the following information for the processing of my application:

SEKSIONI A / SECTION A

1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant			
1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit Information on Passport or travel document			
☐	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
☐	Numri i Pasaportës Shërbimi / Official passport no.		
☐	Numri i Dokumentit të udhëtimit të refugjatit / Refugee's travel document no.		
☐	Numri i Pasaportës për të huajt / Alien's passport no.		
☐	Dokument tjetër, specifikoj llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
Vendi i lëshimit Country of issue	Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue	Data e skadimit Date of expiry
1.2 Të dhëna personale / Personal data			
Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënës		Emri i babait	

Mother's name			Father's name		
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth			ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)		
Shteti i lindjes Country of birth			Vendi i lindjes / Place of birth		
Gjinia /Gender: ☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown					
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)					
Gjendja Civile / Civil status ☐ Martuar / Married ☐ Beqar / Single ☐ Divorcuar / Divorced ☐ I(e) Ve / Widow(er) ☐ Partner Civil / Civil Partner					
Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:				Gjuha mëmë: Mother Tongue:	
1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj. If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.					
Bashkia Municipality			Njësia Administrative Administrative Units		
Fshati/Qyteti City / Town			Rruga Street		
Ndertesa nr. Building No.			Hyrja The Entrance		
Kodi Postar Postal Code			Apartamenti Apartment		
Tel. / Cel. / Fax					
E-mail:					
2 Informacion mbi anëtarët e familjes / Information on family members 2.1 Bashkëshorti ose Partneri civil/ Spouse or civil partner ☐ I pamartuar /No spouse					
Mbiemri / Family name:			Emrat / First names		
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth			ID Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)		
Shtetësia (te) aktuale Current citizenship(s)					
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati): Address (street, no, city/country):					
2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari No children in my care					
Ju lutemi deklaroni të gjithë fëmijët në kujdestari pavarësisht nëse ju po aplikoni për leje qëndrimi Shqiptare për ta ose jo. Nëse leja e qëndrimit të përhershme kërkohet për një fëmijë, duhet të plotësohet një formular aplikimi i veçantë për të. Please declare all your underage children regardless of whether you are applying for a Albanian residence permit for them or not. If a permanent residence permit is being sought for a child, a separate application form must be filled in for him/her.					
Emri / First name	Mbiemri /Family name	Datëlindja(ddmmYYYY) / Date of birth			
		☐ Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application			
		☐ Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application			
		☐ Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application			
		☐ Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application			
		☐ Aplikim njëkohësisht Simultaneous Application			

Nëse keni më shumë se pesë fëmijë, vendosni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë
If you have more than five children, enclose the information on the remaining children in a separate appendix.

2.3 Banesa / Residence

Ambienti i banimit: ☐ Ambient kolektiv pensione /hostel ☐ Hotel
Place of residence: Collective accommodation/hotel

☐ Apartament me: Kontratë Qira mujore m²
Apartment with Monthly Rent Contract

Qira ditore rezervuar nëpërmjet platformave online m²
Daily rental booked through online platforms

Në pronësi m²
Owned

Deklaratë Bashkëjetese në ambientet e një të afërmi m²
Declaration of Cohabitation in the premises of a relative

Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/ çdo dokument tjetër që provon akomodimin
I am enclosing with the application the rent contract / proof of property/ any other document proving accommodation

SEKSIONI B / SECTION B

3. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania

3.1 Arsyet e qëndrimit/ Grounds for residence

Kur dhe në cilin PKK keni hyrë/do të hyni në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / When and in which BCP did you enter/will you enter to Albania?

Datë/Date: PKK/ BCP: Numri i hyrjeve të mëparshme/ previous entry :
Targa e automjetit⁶ / Vehicle license plate: Tipi automjetit/ Vehicle type:
Dokumenti i pronësisë/ Ownership document

Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri? / What are the grounds for your residence in Albania?

☐ Bashkim familjar me shtetas shqiptar ☐ Bashkim familjar me shtetas të huaj
Family unification with albanian Family unification with foreigner

☐ Lidhje familjare: bashkëshort , partner civil / Family ties: spouse, civil partner
☐ Lidhje familjare: prind, kujdestar / Family ties: parent, guardian
☐ Lidhje tjetër familjare (specifikoje) / Other family ties(specify):

3.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay

Unë aplikoj për leje qëndrimi me afat / I'am applying for a permit term: Shëno Afatin:

3.3 Informacion mbi ftuesin / Information on sponsor

⁶ Për tu plotësuar, nëse gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë keni në përdorim një automjet të regjistruar në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë./ To be completed, if during your stay in the Republic of Albania you have in use a vehicle registered in a country outside the Republic of Albania

Lidhja me ftuesin / The relationship with sponsor			
☐ Bashkëshort /Spouse ☐ Partner civil /Civil partner ☐ Prind /Parent ☐ Kujdestar /Guardian ☐ Të tjera /Others			
Unë kam bashkëngjitur dokumentin që provon lidhjen familjare së bashku me aplikimin I am enclosing the document proving the family relationship of with my application			
Mbiemri / Family name:		Emrat / First names :	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		Leja e qëndrimit në Shqipëri (nëse ka) Albanian resident Permit (if applicable)	
Shtetësia (të) aktuale Current citizenship(s)		ID Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati) / Address (street address, no, city/country):			
Tel. :		E-mail:	
3.4 Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor Incomes and health insurance			
Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme së bashku me aplikimin: I am enclosing the following clarifications with my application:			
☐ Dëshminë e gjendjes bankare / Certificate of Bank statement ☐ Dëshmi e të ardhurave të ftuesit (sponsorit) / Certificate of sponsor incomes ☐ Të ardhura personale ose familjare / Personal or familiar funds ☐ Vërtetim të sigurimeve shëndetësore / Health insurance certificate			

SEKSIONI C / SECTION C

4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application
A keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar? Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?
☐ Jo/ No ☐ Po, specifikoj vepren penale dhe sa jeni dënuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment
A vuani nga ndonjë sëmundje? Do you suffer from any diseases?
☐ Jo/ No ☐ Po, specifikoj sëmundjen: / Yes, specify the disease:

SEKSIONI D / SECTION D

5 Deklarime përfundimtare / Last declarations
--

Foto Photo	Unë po aplikoj për një leje qëndrimi në Shqipëri. Konfirmoj se, informacioni dhe dokumentet e paraqitura në këtë aplikim janë korrekte dhe të sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacion të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së qëndrimit ose të heqjes së lejes ekzistuese, riatdhesimin dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë. I am applying for a Albanian residence permit. Hereby affirm that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.															
<table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 25%;">DEKLARUESI:</td> <td style="width: 25%;">☐ Aplikanti</td> <td style="width: 25%;">☐ Personi i autorizuar</td> <td style="width: 25%;">☐ Punëdhënësi</td> </tr> <tr> <td>THE DECLARANT:</td> <td>Himself</td> <td>The person authorized</td> <td>Employer</td> </tr> </table>		DEKLARUESI:	☐ Aplikanti	☐ Personi i autorizuar	☐ Punëdhënësi	THE DECLARANT:	Himself	The person authorized	Employer							
DEKLARUESI:	☐ Aplikanti	☐ Personi i autorizuar	☐ Punëdhënësi													
THE DECLARANT:	Himself	The person authorized	Employer													
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 30%;">Mbiemri / Family name</td> <td style="width: 30%;">Emrat / First names</td> <td style="width: 40%;"></td> </tr> <tr> <td>Datëlindja (dd.mm.yyyy)</td> <td>ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka)</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shteti i lindjes</td> <td>Vendi i lindjes / Place of birth</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Gjinia /Gender:</td> <td colspan="2"> ☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown </td> </tr> <tr> <td>Shtetësia (të) / Current citizenship(s)</td> <td colspan="2"></td> </tr> </table>		Mbiemri / Family name	Emrat / First names		Datëlindja (dd.mm.yyyy)	ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka)		Shteti i lindjes	Vendi i lindjes / Place of birth		Gjinia /Gender:	☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown		Shtetësia (të) / Current citizenship(s)		
Mbiemri / Family name	Emrat / First names															
Datëlindja (dd.mm.yyyy)	ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka)															
Shteti i lindjes	Vendi i lindjes / Place of birth															
Gjinia /Gender:	☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown															
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)																
<table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 45%;">Vendi dhe data</td> <td style="width: 55%;">Nënshkrimi</td> </tr> <tr> <td>Place and date _____</td> <td>Signature _____</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Emri me shkronja kapitale</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Name in block letters _____</td> </tr> </table>		Vendi dhe data	Nënshkrimi	Place and date _____	Signature _____		Emri me shkronja kapitale		Name in block letters _____							
Vendi dhe data	Nënshkrimi															
Place and date _____	Signature _____															
	Emri me shkronja kapitale															
	Name in block letters _____															

SEKSIONI E / SECTION E

6 Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices

Me poshtë janë listuar sqarimet e nevojshme, si shtojcat në këtë aplikim për leje qëndrimi. Gjatë aplikimit duhet të ngarkohen certifikata origjinale dhe deklarata, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, duhet të përkthehen nga përkthyes të autorizuar dhe të legalizohen sipas marrëveshjeve ndërmjet shteteve.

The clarifications listed below are required as appendices to this residence permit application. The original certificates and clarifications must be uploaded when submitting the application; if they are not in Albanian, they must be translated by an authorized translator and must be legalized.

Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.

Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

- ☐ **Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit (originali të paraqitet, kur dorëzon kërkesën për leje qëndrimi)**
Photocopy of valid travel document (the original must be presented when submitting the residence permit application)
- ☐ **Dy fotografi (47mmX36mm) të bëra jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit**
Passport photo (47mmX36mm)
- ☐ **Për një fëmijë të mitur, deklaratën noteriale me shkrim nga prindi i cili nuk është personi i paraqitjes së kërkesës**
For an underage child, written consent from the parent who is not the person submitting the application
- ☐ **Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 2.3)**
Clarification of accommodation (documentation referred to in point 2.3)
- ☐ **Sqarim i të ardhurave dhe sigurimit shëndetësor (dokumentacione apo sqarime të përmendura në pikën B/IV)**
Clarification of income source and health insurance (documentation or clarification referred to in point B/IV)

☐	Certifikata familjare dhe/ose e martesës Family and / or marriage certificate
☐	Deklarata noteriale për bashkëjetesë për bashkim familjar për partnerë civilë Notarized declaration of cohabitation for family reunification for civil partners
☐	Mandati i pagesës për tarifën e shërbimit* Mandate of payment for the service fee*
☐	Deklaratë/autorizimi Declaration/ authorization
☐	Dokumente të tjera Other documents

***Para përfundimit të aplikimit, duhet të ngarkoni mandatin e pagesës (pagesë për vizë/leje qëndrimi)**
*Before completing the application, you must upload the mandate of payment (payment for visa / residence permit)

SEKSIONI F / SECTION F

7 Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin To be filled out by the official person to whom the application was submitted	
Tipi i lejes që përfitohet: ☐ KARTA B	Afati: _____ muaj
_____, më: _____	Nënshkrimi i zyrtarit: _____

Për motive arsimi, trajnimi dhe kërkimi shkencor:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KARTA B

ID _____

APLIKIM PËR LEJE QENDRIMI / RESIDENCE PERMIT APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për leje qëndrimi Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes aplikimin. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në www.asp.gov.al → English → Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin E të këtij formulari.

This form is for applying for a Albanian residence permit. Carefully fill in the application. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. Read the instructions for filling in the form at www.asp.gov.al → English → Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section E of this form.

Aplikim për
Application for

☐ Leje qëndrimi për herë të parë
A first residence permit

☐ Rinovim leje qëndrimi
Renewed residence permit

dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:
and hereby submit the following information for the processing of my application:

SEKSIONI A / SECTION A

1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant			
1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit Information on Passport or travel document			
☐	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
☐	Numri i Pasaportës Shërbimi / Official passport no.		
☐	Numri i Dokumentit të udhëtimit të refugjatit / Refugee's travel document no.		
☐	Numri i Pasaportë për të huajt / Alien's passport no.		
☐	Dokument tjetër, specifiko llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
Vendi i lëshimit Country of issue		Autoriteti i lëshimit Authority of issue	Data e lëshimit Date of issue
			Data e skadimit Date of expiry
1.2 Te dhëna personale / Personal data			
Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënes Mother's name		Emri i babait Father's name	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia / Gender:		☐ Mashkull / Male ☐ Femër / Female ☐ E panjohur / Unknown	

Shtetësia (të) / Current citizenship(s)			
Gjendja Civile / Civil status			
☐ Martuar / Married	☐ Beqar / Single	☐ Divorcuar / Divorced	☐ I(e) Ve / Widow(er) ☐ Partner Civil / Civil Partner
Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:		Gjuha mëmë: Mother Tongue:	
1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj. If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.			
Bashkia Municipality		Njësia Administrative Administrative Units	
Fshati/Qyteti City / Town		Rruga Street	
Ndertesa nr. Building No.		Hyrja The Entrance	
Kodi Postar Postal Code		Apartamenti Apartment	
Tel. / Cel. / Fax			
E-mail:			
2 Informacion mbi anëtarët e familjes / Information on family members 2.1 Bashkëshorti ose Partneri civil/ Spouse or civil partner ☐ I pamartuar /No spouse			
Mbiemri / Family name :		Emrat / First names:	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shtetësia (te) aktuale Current citizenship(s)			
Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati) Address (street, no, city/country)			
2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari No children in my care Ju lutemi deklaroni te gjithë fëmijët në kujdestari pavarësisht nëse ju po aplikoni për leje qëndrimi Shqiptare për ta ose jo. Nëse leja e qëndrimit të përhershme kërkohet për një fëmijë, duhet të plotësohet një formular aplikimi i veçantë për të. Please declare all your underage children regardless of whether you are applying for a Albanian residence permit for them or not. If a permanent residence permit is being sought for a child, a separate application form must be filled in for him/her.			
Nëse keni më shumë se pesë fëmijë, vendosni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë If you have more than five children, enclose the information on the remaining children in a separate appendix.			
2.3 Banesa / Residence			
Ambjenti i banimit: ☐ Ambient kolektiv pensione /hostel ☐ Hotel Place of residence: Collective accommodation/hotel			
☐ Apartament me: Apartment with	Kontratë Qira mujore m² Monthly Rent Contract Qira ditore rezervuar nëpërmjet platformave online m² Daily rental booked through online platforms Në pronësi m² Owned Deklaratë Bashkëjetese në ambientet e një të afërmi m² Declaration of Cohabitation in the premises of a relative		

Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/ çdo dokument tjetër që provon akomodimin
I am enclosing with the application the rent contract / proof of property/ any other document proving accommodation

SEKSIONI B / SECTION B

3. Informacion mbi qëndrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania

3.1 Arsytet e qëndrimit/ Grounds for residence

Kur dhe në cilin PKK keni hyrë/do të hyni në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / When and in which BCP did you enter/will enter to Albania?

Date/Date: PKK/ BCP: Numri i hyrjeve të mëparshme/ previous entry :
Targa e automjetit⁷/ Vehicle license plate: Tipi automjetit: Dokumenti i pronësisë

Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri? / What are the grounds for your residence in Albania?

- ☐ Student / Student ☐ Nxënës Shkolle / School pupil
☐ Kërkime shkencore / Scientific Research ☐ Për kërkimin e punës ose sipërmarrjen / For job search or entrepreneurship
☐ I trajnuar pa pagesë / Unremunerated Trainee ☐ Arsye të tjera / Other reason
☐ Shkëmbime rinore /

3.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay

Unë aplikoj për leje qëndrimi me afat / I'am applying for a permit term: Shëno Afatin:

3.3 Informacion mbi studimet në Shqipëri / Information on study in Albania

Shëno motivin / Sign the reason reasons

- ☐ Institucion Edukimi ne Shqipëri / Educational Institution in Albania ☐ Program trajnimi / Training Program ☐ Të tjera / Others

Emërtimi i Institucionit, Programit etj.:
Name of Institution, Program etc.:

Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati, shteti):
Address (street address, no, city/town, country):

Tel. :

E-mail:

Gjuha e studimit/ Study Language

- ☐ Shqip/Albanian ☐ Anglisht/English ☐ Të tjera/Others

⁷ Për tu plotësuar, nëse gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë keni në përdorim një automjet të regjistruar në një vend jashtë Republikës së Shqipërisë./ To be completed, if during your stay in the Republic of Albania you have in use a vehicle registered in a country outside the Republic of Albania

3.4 Të ardhurat dhe sigurimi shëndetësor / Incomes and health insurance

Une kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme së bashku me aplikimin:

I am enclosing the following clarifications with my application:

- ☐ Depozitë bankare ose dëshminë e gjendjes bankare / Certificate deposit or Bank statement
- ☐ Dëshmi për bursë studimi, ndihmë ose përfitime të tjera / Certificate of scholarship, grants or other benefits
- ☐ Të ardhura personale ose familjare / Personal or familjar funds
- ☐ Vërtetim të sigurimeve shëndetësore për periudhën e studimit / Health insurance certificate for terms of study

SEKSIONI C / SECTION C

4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application

A keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar?

Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?

- ☐ Jo/ No
- ☐ Po, specifiko veprën penale dhe sa jeni dënuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment

A vuani nga ndonjë sëmundje?

Do you suffer from any diseases?

- ☐ Jo/ No
- ☐ Po, specifiko sëmundjen: / Yes, specify the disease:

SEKSIONI D / SECTION D

5 Deklarime përfundimtare / Last declarations

